



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 365/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Fadil Beka nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja, me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fadil Beka nga koalicioni PDK-AAK-NISMA,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, në Vendvotimin 2121B/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

IV. Sherif Smakiqi me nr. të letërnjoftimit 1010485343, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2121B/01R, i ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet në Kuvendit të Republikës së Kosovës Fadil Beka nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se nuk janë pasqyruar numri i votave në formularin për shkak se sipas kryesuesit të vendvotimit kjo ka ndodhur për shkak të lodhjes dhe ngarkesës në punë dhe sipas vëzhguesve konstatohet se ka pasur vota në këtë vendvotim dhe kërkojmë që të hapet kutit e vendvotimit për hire të transparencës. Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e FRK-vë, me numër 2121B/01R për vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi si dhe dëshmitaret-vëzhguesit në qendrën e vendvotimit.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2121B/01R, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.53, nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, Komuna e Prishtinës, nuk ka asnjë votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 101 vota të vlefshme.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pasi hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 101 vota.

Nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LPZ-së, urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 pika d, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 365/2017 më datën 02.07.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.